



REPUBLIKA E KOSOVES-REPUBLIKA KOSOVA-REPUBLIC OF KOSOVO  
KËSHILLI I PAVARUR MBIKËQYRËS PËR SHËRBIMIN CIVIL TË KOSOVËS  
NEZAVISNI NADZORNI ODBOR CIVILNE SLUŽBE KOSOVA  
INDEPENDENT OVERSIGHT BOARD CIVIL SERVICE OF KOSOVO



Pranuar / Dorezuar Prilijeno / Prilijeno Received / Delivery	15-04-2022	2	viti god year
Organ / Njësia Organ / Jedinica Org. / Unit	Nr. Prot. Br. Prot. Prot. No.	Shtesa Prilog Appendix	Sasia Kolicina Quantity
SKPM/SHCK	2184/2022		1/6



## Republika e Kosovës Republika Kosova – Republic of Kosovo

KËSHILLI I PAVARUR MBIKËQYRËS PËR SHËRBIMIN CIVIL TË KOSOVËS  
NEZAVISNI NADZORNI ODBOR CIVILNE SLUŽBE KOSOVA  
INDEPENDENT OVERSIGHT BOARD FOR THE CIVIL SERVICE OF KOSOVO

A.nr.203/2022

Këshilli i Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës-Kolegji për Shqyrtimin dhe Vendosjen e Ankesave në përbërje nga: Ardita Haxhnikaj-Demi-kryetare, Arben Mehmeti dhe Jeton Koc-anëtarë, me Avdyl Bektashi-Zyrtar i Lartë për Bashkëpunim Profesional në cilësinë e procesmbajtësit, ka shqyrtuar ankesën me numër A.nr.203/2022 të datës 03.03.2022 të parashtruar nga kundër Vendimit KD.Nr.001/22 të datës 09.02.2022 të Komisionit Disiplinor të Shërbimit Korrektues të Kosovës, në çështjen juridike "masë disiplinore, duke vepruar në pajtim me nenin 6 paragrafin 1 nënparagrafin 1.1 dhe nenin 18 paragrafin 1 nënparagrafin 1.1 të Ligjit Nr.06/L-048 për Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës dhe Rregulloren Nr.02/2018 për Procedurën e Shqyrtimit dhe Vendosjes së Ankesave në Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, në seancën për këshillim dhe votim, me datë 15.04.2022, njëzëri mori këtë:

### V E N D I M

- I. Refuzohet si e pabazuar ankesa me numër A.nr.203/2022 e datës 03.03.2022 e parashtruar nga ankuesja
- II. Mbetet në fuqi Vendimi KD.Nr.001/2022 i datës 09.02.2022 i Komisionit Disiplinor të Shërbimit Korrektues të Kosovës.

### A r s y e t i m

Ankuesja e punësuar në Shërbimin Korrektues të Kosovës, më datë 03.03.2022 ka parashtruar ankesë me numër protokoli 1138/2022 e regjistruar me A.nr.203/2022, në Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, kundër Vendimit KD.Nr.001/22 të datës 09.02.2022 të Komisionit Disiplinor të Shërbimit Korrektues të Kosovës.

Këshilli i Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës (tutje referuar Këshilli) bazuar në dispozitat e Rregullosës Nr.02/2018 për Procedurën e Shqyrtimit dhe Vendosjes së Ankesave në Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, më datë 07.03.2022 ka proceduar kërkesën për përgjigje në ankesën e ankuesit tek Shërbimi Korrektues të Kosovës. Ndërsa Këshilli me datë 14.03.2022 ka pranuar nga Shërbimi Korrektues i Kosovës përgjigjen në kërkesë me numër protokoli 1333/2022 së bashku me shkresat e bashkangjitura.



*Kolegji për Shqyrtimin dhe Vendosjen e Ankesave, për vërtetimin e plotë dhe të drejtë të gjendjes faktike si dhe vendosje në mënyrë meritore, ka administruar këto prova:* Ankesën me numër protokoll 1138/2022 të datës 03.03.2022 e parashtruar nga ankuesja në Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës; Vendimin KD.Nr.001/2022 të datës 09.02.2022 të Komisionit Disiplinor të Shërbimit Korrektues të Kosovës; Kërkesën për Përgjigje në ankesë datës 07.03.2022; Përgjigjen në ankesë e datës 14.03.2022; Vendimin me Nr.1557 të datës 21.12.2020 për transferimin e ankueses; Kontratë pune për kohë të pacaktuar e datës 30.06.2020 për ankuesen; Raportin i vetëvrasje së të burgosurës i datës 30.12.2021; Raporti i ngjarjes/incidentit/shkelje i datës 30.12.2021 nga B.S, M.H, SH.M; Plani eventual-vdekja në burg i datës 30.12.2021; Regjistrimet Ditore; Shkresë për inicimin e procedurës disiplinore ndaj ankuesit e datës 12.01.2022; Raporti i Hetimit i datës 11.01.2022; Raporti lidhur me rastin e vetë varjes së të dënuarës i datës 06.01.2022; Ndryshimin dhe Plotësimin e Kontratës e datës 07.05.2019; Kontratë Pune për kohë të Pacaktuar e datës 02.11.2018; Raporti i Hetimit i Shërbimit Korrektues të Kosovës i datës 30.12.2021; Raportin propozues nga Komisioni multidisciplinar për menaxhimin e rasteve me rrezik për vetëvrasje i datës 14.05.2021 me numër reference MSh/DSH/QKFL/55/2021; Deklaratën e datës 31.12.2021 të Zv/Drejtoreshës L.S; Regjistrimet ditore të gjendjes dhe sjelljeve të burgosurit M.K; Deklaratën e datës 31.12.2021 të udhëheqëses së pavijonit R.L; Raportin e Ngjarjes i datës 30.12.2021 nënshkruar nga H.K; Raportin mbi gjendjen shëndetësore të paraburgosurve të datës 02.11.2021 me numër Nr.508; Raportin mbi gjendjen shëndetësore të paraburgosurve të datës 10.09.2021 me numër Nr.551; Raportin mbi gjendjen shëndetësore të paraburgosurve të datës 20.09.2021 me numër Nr.576; Deklarata e V.U; Deklarata e S.Y; Njoftimin për vdekje në burg i datës 30.12.2021; E-mailin e datës 30.12.2021 dërguar nga F.M për I. D; Vendimin e datës 20.10.2021 për themelimin e Komisionit; Regjistrimet ditore të gjendjes dhe sjelljeve të burgosurit M.K të datës 30.12.2021; E-mailin e datës 03.09.2021 dërguar nga S.B dërguar G.M; Njoftimin e datës 06.09.2021 dërguar nga menaxheri i rastit N.S dërguar për S.B; Regjistrimet ditore të gjendjes dhe sjelljeve të burgosurit M.K e datës 29.12.2021; Regjistrimet ditore të gjendjes dhe sjelljeve të burgosurit M.K e datës 28.12.2021; Raporti i Mbledhjes Shëndetësore i rastit M.K i datës 30.12.2021 përgatitur nga Dr. L.H, Udhëheqëse e NJSHB/QKFL; Deklaratën e datës 30.12.2021 nga Kryeinfermierja A.S; Deklaratën e datës 30.12.2021 nga H. Q; Raporti Mjekësor i datës 30.12.2021; Plani Eventual-Vdekja në burg-Procedura e veprimit të oficerit në dhomën e kontrollit i datës 30.12.2021; Deklaratën 38 të S.Y; Deklaratën 39 e V.T; Shkresën e datës 30.12.2021 me numër rendor:304 me shkresën e bashkangjitur të datës 31.12.2021 prej tre (3) faqesh; Procesverbalin e intervistës me stafin i datës 05.01.2022 me katër (4) shkresat e bashkangjitura të datës 31.12.2021; Shkresën e procesverbalit të datës 05.01.2022 i orës 10:30; Shkresën e procesverbalit të datës 05.01.2022 i orës 09:50; Shkresën e procesverbalit të datës 05.01.2022 i orës 14:55; Shkresën e procesverbalit të datës 05.01.2022 i orës 14:00; Shkresën e procesverbalit të datës 05.01.2022 i orës 11:00; Shkresën e procesverbalit të datës 06.01.2022 i orës 10:35; Shkresën e procesverbalit të datës 06.01.2022 i orës 11:25; Shkresën e procesverbalit të datës 06.01.2022 i orës 12:15; Kartoni i evidencës së vizitorëve sipas listës së planifikuar Form 3.3.2/1; Kërkesa për kontroll ose hospitalizim e datës 15.09.2020 për M. K; Kërkesa për kontroll ose hospitalizim e datës 15.02.2021 për M. K; Fletë lëshimi i datës 25.03.2021 me numër amzës:34/29; Raporti i Departamentit Shëndetësor të Burgjeve i datës 28.04.2021 në përbërje prej njëzetedy (22) faqesh; Aktvendimin me numër P.nr.328/21e Gjykatës Themelore në Prishtinë-Departamenti i Përgjithshëm i datës 27.04.2021; Aktgjykimin me numër P.nr.328/21 i Gjykatës Themelore në Prishtinë-Departamenti i Përgjithshëm i datës 25.05.2021; Aktgjykimin me numër PA1.nr.798/2021 i Gjykatës së Apelit të Kosovës i datës 19.08.2021; Vendimi për formimin e komisionit të brendshëm hetimor i datës 31.12.2021; Aktvendimin e Panelit për lirim me kusht me numër PLK.D.nr.563/21; Raportet përmbledhëse për lirim me kusht i datës 17.09.2021;



Kualifikimi për shqyrtim për lirim me kusht për të dënuarën M. K i datës 20.09.2021; Raportin përmbledhës nga Ekipa profesioniste e institucionit korrektues për lirim me kusht i datës 27.09.2021; Raportin shëndetësor për të burgosurën M.K 23.09.2021; Deklaratën e datës 24.09.2021; Raporti Social për falje i datës 27.09.2021; Deklarim-premtim lidhur me mbikëqyrjen pas lirit me kusht; Raporti përmbledhës për gjykatë për lirim me kusht të parakohshëm i datës 23.12.2021; Kërkesa për lirim të parakohshëm i datës 23.12.2021; E-mailin e datës 24.12.2021 dërguar nga për Raporti i vlerësimit për regjime i datës 04.10.2021; vendimin e datës 07.05.2021 i Drejtorit të QKFL; Raportin Inicues disiplinor; Njoftimi i të burgosurit për akuzën dhe kohën e seancës dëgjimore i datës 06.05.2021; Shënimin Zyrtar i datës 06.02.2021; Vendimin e datës 06.10.2021; Raporti inicues i datës 05.10.2021; Procesverbalet e seancave të komisionit për datat respektive 24 dhe 25.01.2022 për ankuesin dhe të tjerët; Raport inicues i datës 02.09.2021; Raport inicues i datës 06.04.2021; Shkresën zyrtare të datës 06.04.2021; Deklaratën e Raport për dëmtime trupore eventuale i datës 06.04.2021; Raportin e vizitave i datës 30.12.2021; Raportin mi gjendjen shëndetësore të paraburgosurve i datës 03.09.2021; Regjistrin mbi informatat e të burgosurës me numër: QP-LP:000029/21; Procesverbali i intervistës me R.L të datës 22.01.2022; Deklaratën e datës 30.12.2021; Ftesën për intervistë të datës 21.01.2022 për M.A; Ftesën për intervistë të datës 21.01.2022 për L.S; Ftesën për intervistë të datës 21.01.2022 për H.K; Ftesën për intervistë të datës 21.01.2022 për R.L; Ftesën për intervistë të datës 21.01.2022 për ankuesin; Ftesën për intervistë të datës 21.01.2022 për A.K; Ftesën për intervistë të datës 21.01.2022 për B.S; Ftesën për intervistë të datës 21.01.2022 për F.M; Regjistrimet ditore të gjendjes dhe sjelljeve të burgosurit për datën 30.12.2021 nga ora 03:30 deri në ora deri në ora 12: (i pa identifikueshëm numri); Deklaratën e Udhëheqëses së pavijonit R.L e datës 31.12.2021; Raporti i Ngjarjes i datës 30.12.2021 nga zyrtarja B.S.

Kolegji i Këshillit pasi që ka shqyrtuar dhe analizuar të gjitha shkresat e lëndës, konstatoi së janë të pa bazuar pretendimet ankimore të ankueses, *SEPSE*:

Nga administrimi i shkresave të lëndës Kolegji ka gjetur se ankuesja sipas Kontratës për punë për kohë të pacaktuar të datës 30.06.2020 ka qenë e emëruar në pozitën *Zyrtare Korrektuese në Burgun e Sigurisë së Lartë*, ndërsa me Vendimin me Nr.1557 të datës 21.12.2020 të Drejtorit të Përgjithshëm të Shërbimit Korrektues të Kosovës e njëjta është transferuara nga pozita *Zyrtare Korrektuese në Burgun e Sigurisë së Lartë* në pozitën *Zyrtare Korrektuese në Qendrën e Paraburgimit në Lipjan*.

Bazuar në Raportin e Inspektoratit të Ministrisë së Drejtësisë me numër protokollo 01-03 të datës 06.01.2022, Zëvendësuesi i Drejtorit të Përgjithshëm të Shërbimit Korrektues të Kosovës me datë 12.01.2022 ka iniciuar procedurën disiplinore ndaj ankueses me pretendimet se e njëjta me veprimet apo mosveprimet e saj gjatë kryerjes së detyrës zyrtare ka bërë shkelje disiplinore të parapara me nenin 46 paragrafi 3 nën paragrafi 3.1 dhe 3.3 të Ligjit Nr. 06/L-114 për Zyrtarët Publikë.

Komisioni Disiplinor i Shërbimit Korrektues me datë 09.02.2022 ka nxjerrë Vendim me numër KD.Nr.001/2022, ku në pikën VIII të dispozitivit ka shpallur ankuesen përgjegjës për shkelje të rëndë disiplinore nga neni 46 paragrafi 3 nënparagrafi 3.1 të Ligjit Nr.06/L-114 për Zyrtarët Publikë dhe ndaj të njëjtës ka shqiptuar masën disiplinore "*Ndalimi i 20% të pagës për periudhën dy muaj*", e përcaktuar sipas nenit 47 paragrafi 1 nënparagrafi 1.2 të Ligjit Nr. 06/L-114 për Zyrtarët Publikë.

Ankuesja në ankesën e parashtruar në Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, kundër Vendimit me numër KD.Nr.001/2022 të datë 09.02.2022, pretendon që masa e shqiptuar është e padrejtë për faktin që nuk ka bërë asnjë shkelje ligjore.



Bazuar në dispozitat e Ligjit Nr.06/L-114 Për Zyrtarët Publikë i zbatueshëm nga data 09.07.2020 sipas Aktgjykimit me numër reference AGJ 1583/20 të datës 09.07.2020 të Gjykatës Kushtetuese të Republikës së Kosovës, përkatësisht sipas nenit 4 të këtij Ligji me të cilin është përcaktuar se: *1.Nëpunësit profesional të shërbimit diplomatik dhe shërbimi korrektues janë nëpunës civilë me status të veçantë, të cilët rregullohen me këtë ligj dhe me ligj të veçantë, 2.Rregullimi me ligj të veçantë, sipas paragrafit 1 të këtij neni, duhet të jetë në pajtim parimet e përcaktuara me këtë ligj dhe mund t'i rregullojë ndryshe vetëm këto elemente të marrëdhënies së punës: 2.1. kushte të veçanta apo shtesë për rekrutim; 2.2. të drejtat ose detyrimet specifike të tjera nga ato të parashikuara me këtë ligj; 2.3. rregullat e veçanta për zhvillimin e karrierës sipas sistemit të gradave; 2.4. zhvillimin profesional dhe nevojat për trajnime; 2.5. transferimin dhe sistematizimin e nëpunësve, rrjedhimisht me hyrjen në fuqi të këtij ligji, nëpunësit e shërbimit korrektues kanë statusin e nëpunësve civilë me status të veçantë, respektivisht se të njëjtit i nënshtrohen legjislacionit në fuqi për nëpunësit civil si dhe ligjeve të veçanta lidhur me fushat e specifikuara sipas paragrafit 2 të nenit 4 të këtij ligji.*

Lidhur me shqyrtimin e pretendimeve ankimore, Kolegji ka analizuar dispozitat e Ligjit Nr. 06/L-114 për Zyrtarët Publikë, respektivisht kapitullin IV lidhur me Disiplinën në Shërbim Civil, si dhe dispozitat e Rregullores (QRK) Nr.11/2020 për Disiplinën dhe Ankesat e Zyrtarëve Publikë, me të cilën është rregulluar procedura dhe masat disiplinore për nëpunësit civilë, ndërsa në aspekt të përgjegjësisë disiplinore, Kolegji ju referua nenit 45 të Ligjit Nr. 06/L-114 për Zyrtarët Publikë ku theksohet se: *Përgjegjësia disiplinore është moszbatimi apo zbatim jo i duhur i detyrave të punës dhe detyrimeve të tjera ligjore, që përmban elementet si në vijim: 1.1. "ekzistimin e veprimit të paligjshëm apo mosveprimit;" 1.2. kryerjen e veprimit me faj apo mosveprimit; 1.3. ndodhja e pasojës 1.4. ndodhja e dëmit; dhe 1.5. lidhjen shkakësore ndërmjet veprimit të kryer dhe pasojës/dëmit. Ndërlidhur me këtë e në kuptim të nenit 46 paragrafi 3 të të njëjtit ligj si shkelje të rënda disiplinore janë kualifikuar: 3.1. mospërmbushja e detyrave të punës; 3.2. mosrespektimi i afateve të caktuara në përmbushjen e detyrave, të cilat kanë sjellë pasoja të rënda; 3.3. moszbatimi i dispozitave ligjore për përmbushjen e detyrave funksionale; 3.4. përfitimi në mënyrë të drejtpërdrejtë ose të tërthortë të dhuratave, favoreve, premtimeve ose trajtimeve preferenciale, të cilat jepen për shkak të detyrës; 3.5. braktisja e punës ose mungesa e paarsyeshme dhe e vijueshme për pesë (5) ditë pune apo më shumë; 3.6. shkelje e përsëritur e rregullave të kodit të etikës në Shërbimin Civil; 3.7. dëmtimi i pasurisë shtetërore, përdorimi i saj jashtë përcaktimit zyrtar apo keqpërdorimi i pasurisë shtetërore; 3.8. kryerja e përsëritur, brenda ose jashtë orarit zyrtar, të veprimeve që cenojnë nëpunësit civilë, institucionin apo Shërbimin Civil në tërësi; 3.9. shkelja e rregullave për ruajtjen e informacionit të klasifikuar apo të mirëbesimit për të dhënat e klasifikuara si të tilla; 3.10. shkelja e detyrimeve të përcaktuara në këtë ligj dhe në legjislacionin në fuqi; 3.11.Përdorimi i narkotikëve dhe substancave të tjera psikotrope të ndaluara ose të alkoolit në vend të punës dhe ardhja i delur në punë .*

Nga vlerësimi i provave të lëndës përkatësisht bazuar në Raportin e Komisionit Hetimor të datës 30.12.2021, Kolegji ka gjetur se me datë 30.12.2021 e dënuara M. K rreth orës 12:36 ishte vetëvrarë me jelekun e saj në dritaren e dhomës. Me tej, sipas raportit në fjalë rrjedhë së stafi menaxherial prezent në ditën e ngjarjes nuk kishin arritur të menaxhoj në mënyrë profesionale rastin e incidentit të vetëvrasjes së të dënuarës M.K, duke mos bërë sigurimin e vendit të ngjarjes, tutje e vetë varura gjate ditës së ngjarjes nuk ishte vëzhguar sipas kohës së përshkrimit në formularin përkatës për vëzhgim, ndërsa ankuesja në cilësi të zyrtares korrektuese kishte mbyll të vetëvrarën në dhomën e saj dhe e njëjta kishte bërë hapjen e dhomave të të dënuarve në ora 11:55, mirëpo nuk e kishte vizituar sipas planit të vëzhgimit që duhet të ishte çdo 30 minuta edhe pse në formularin e vëzhgimit kishte shënuar se e dënuara është e qetë.



Po nga Raporti i Inspektoratit të Ministrisë së Drejtësisë të datës 06.01.2022, rezulton se ka pasur shkelje ligjore gjatë procedurës së mbylljes së të dënuarës M.K pa pasur rekomandim apo konsultë me psikologjen dhe neoropsikiatrin për të ndërmarr veprimin e mbylljes së të dënuarës pasi që e njëjta ka qenë në terapi psikiatrike, ka pasur shkelje të procedurave ligjore lidhur me observimin nga stafi korrektues pasi raporti i observimit i datës 30.12.2021 ishte plotësuar pa u shikuar për së afërmi e dënuara M.K. gjegjësisht stafi korrektues nuk kishte bërë observimin por vetëm kishte plotësuar formularët.

Komisioni Disiplinor i Shërbimit Korrektues sipas Vendimit KD.Nr.001/2022 të datës 09.02.2022 ka konstatuar së ankuesja në cilësi të zyrtares korrektuese më datë 30.12.2021 ka pranuar detyrën dhe ka qenë në krahun B, mirëpo në kohën e drekës e ka zëvendësuar zyrtaren, në Krahun A, deri rreth orës 12:15, e njëjta edhe përkundër faktit se ka deklaruar se në kohën e numërimit dhe mbylljes e dënuara M.K ka qenë ulur, ndërsa me rastin kur ka bërë hapjen e njëjta ka qenë e shtrirë, sipas incizimeve të kamerave e njëjta nuk afrohet të dera e të dënuarës për asnjë moment, gjegjësisht në bazë të monitorimit të kamerave është gjetur se në formularin zyrtar të observimit i datës 29/30.12.2021 nga ora 03:30 minuta deri në ora 08:00 nuk ka pasur observim nga stafi por vetëm plotësim i formularit pa e parë gjendjen fizike të dënuarës.

Andaj, bazuar në gjendjen e fakteve si me lartë Kolegji për Shqyrtimin dhe Vendosjen e Ankesave, vlerëson se veprimet/mos veprimet e ankuesit në ditën e vet varjes së të dënuarës M.K janë në shperputhje me nenin 25 të Ligjit Nr. 06/L-114 për Zyrtarët Publikë, ku përcaktohet se: *Zyrtari publik detyrohet të respektojë Kushtetutën dhe ligjin dhe të mbrojë interesin e shtetit dhe të drejtat dhe liritë e njeriut. 2. Zyrtari publik ushtron detyrat e tij me profesionalizëm, paanësi, pa diskriminim, në kohë, pa interes personal dhe në përputhje me ligjin dhe kodin e etikës. 3. Zyrtari publik duhet të veprojë në përputhje me parimet e përcaktuara me këtë ligj, kodin e etikës dhe veprimet e tij duhet të jenë në funksion të themelimit dhe përforcimit të besimit të ndërsjellë dhe bashkëpunimit ndërmjet qytetarëve dhe administratës publike*, nisur nga ky konstatim, rezulton së Komisioni Disiplinor ka vërtetuar drejtë gjendjen faktike duke konstatuar saktë përgjegjësinë disiplinore të ankueses si dhe ka cilësuar drejtë veprimet e të njëjtës si shkelje të rëndë disiplinore siç përcaktohet me nenin 46 paragrafi 3 nënparagrafi 3.1 të Ligjit Nr.06/L-114 për Zyrtarët Publikë. Po ashtu, Kolegji vlerëson se Komisioni Disiplinor ka zbatuar drejtë dispozitat e Ligjit Nr.06/L-114 për Zyrtarët Publikë përkatësisht ka vepruar në pajtim me nenin 48 paragrafi 3 dhe nenin 50 paragrafi 1 të këtij Ligji, me të cilin theksohet se: *neni 48 paragrafi 3 ...3: Masat disiplinore të parashikuara në paragrafin 1.2 deri 1.4 të nenit 47 të këtij ligji, janë në kompetencën e komisionit disiplinor..... neni 50..Për përcaktimin e masës disiplinore të zbatueshme, mbikëqyrësi i drejtpërdrejtë ose komisioni disiplinor bazohet në: 1.1. shkaqet, rrethanat e kryerjes së shkeljes, rëndësinë dhe pasojat e saj; 1.2. shkallën e fajësisë; 1.3. ekzistencën e masave të tjera disiplinore të mëparshme të pashlyera, sipas nenit 47 të këtij ligji; 1.4. përpjekjet e mëparshme të nëpunësit për shmangien apo kufizimin e dëmit. 2. Masat disiplinore jepen në raport të drejtë me shkeljen e kryer. 3. Për shkeljet e rënda, jepen masat disiplinore të përcaktuara në paragrafët 1.2 deri 1.4 të nenit 47 të këtij ligji.*, rrjedhimisht Kolegji vlerëson së janë të pabazuara pretendimet ankimore të ankueses së masa e shqiptuar është e padrejtë për faktin që nuk ka bërë asnjë shkelje ligjore.

Kolegji i Këshillit nga analizimi i vendimit të kundërshtuar me ankesë vërën se i njëjti ju referohet tetë (8) zyrtarëve, ku që të gjithë janë shpallur përgjegjës duke ju shqiptuar masa disiplinore veç e veç, kështu që refuzimi i ankesës A.nr.203/2022 të datës 03.03.2022 dhe lënia në fuqi e Vendimit KD.Nr.001/2022 i datës 09.02.2022 të Komisionit Disiplinor ka të bëjë vetëm me pikën VIII të dispozitivit të këtij vendimi.



Siç u tha me sipër, Kolegji për Shqyrtimin dhe Vendosjen e Ankesave pas shqyrtimit të shkresave të lëndës si dhe duke u bazuar në nenin 18 paragrafin 1 nënparagrafin 1.1 të Ligjit Nr. 06/L-048 për Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës si dhe nenin 132 paragrafit 2 të Ligjit Nr.05/L-031 Për procedurën e Përgjithshme Administrative, vendosi si në dispozitiv të këtij Vendimi.

Vendimi hyn në fuqi në ditën e nënshkrimit nga Kryetarja e Kolegjit.

**Këshillë juridike:**

*Kundër vendimit të Këshillit, pala e pakënaqur mund të iniciojë konflikt administrativ në Gjykatën Themelore në Prishtinë-Departamenti për Çështje Administrative, brenda afatit prej tridhjetë (30) ditësh nga dita në të cilën i është dorëzuar vendimi. Inicimi i konfliktit administrativ nuk e ndalin ekzekutimin e këtij vendimi.*

**KËSHILLI I PAVARUR MBIKËQYRËS PËR SHËRBIMIN CIVIL TË KOSOVËS**

Lënda me numër A.nr.203/2022

**Avdyl BEKTESHI**

*Procesmbajtës*



**Vendimi i dërgohet:**

- Ankueses
- Drejtorit të Përgjithshëm të Shërbimit Korrektues të Kosovës;
- Udhëheqësit të Burimeve Njerëzore në Shërbimin Korrektues të Kosovës; dhe
- Arkivit të KPMSHCK-së.

